



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:173603
Datë: 04.11.2024
Numri i dokumentit: 06395864

K.DH.SH.II.nr.1286/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Eurosig” SH.A. me seli në Prishtinë, rruga “2 korriku” nr.4. të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Filloreta Mustafa Hasani kundër debitorit “Trepça” SH.A., me seli në Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fatjana Bekteshi, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.33/24 dt.24.05.2024, me datën 01.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit “ Kompania e Sigurimeve “Eurosig” SH.A. me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.33/24 dt.24.05.2024, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: **REFUZOHET NË TËRËSI** i pabazuar prapësimi i debitorit Bashkimi Projekt Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.715/24 të datës 05.06.2024, të nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferi, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.33/24 dt.24.05.2024, në dispozitiv të aktvendimit ka vendosur si në vijim: I. **APROVOHET** pjesërisht prapësimi i debitorit “Trepça” SH.A., dhe **ANULOHET** pjesërisht Urdhri Përmbarimor P.nr.656/21i datës 22.06.2021, i Përmbaruesit Privat Bardh B. Tasholli për pjesën e detyrimit në shumën prej 5,932.00€, (pesëmijë e nëntëqind e tridhjetë e dy euro) sipas Faturës Nr.023256 të datës 15.08.2018. II.

REFUZOHET PJESËRISHT si i pabazuar prapësimi i debitorit “Trepça” SH.A., dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.656/21 të datës 22.06.2021, i Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli për shumën prej 90,987.80€ (nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë euro) sipas Faturës Nr.027777 të datës 03.09.2019 dhe Faturës Nr. 031553 të datës 21.08.2020. III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “Eurosig” SH.A. ndaj “Trepça” SH.A., sipas urdhrin P.nr.656/21 të datës 22.06.2021, shumën prej 5,932.00€, (pesëmijë e nëntëqind e tridhjetë e dy euro) sipas Faturës Nr.023256 të datës 15.08.2018 IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta shfuqizoj aktvendimin e atakuar, urdhrin përmbartimor ta anuloj në tërësi dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rivendosje.

Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkalles së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitori është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Eurosig” SH.A SH.P.K. ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.656/21 të datës 22.06.2021, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës Nr.023256 e datës 15.08.2018 në shumën prej 5,932.00€, Faturës Nr.027777 e datës 03.09.2019 në shumën prej 45,993.60€ si dhe Faturës Nr. 031553 e datës 21.08.2020 në shumën prej 44,994.20€, me të cilin ka detyruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 96,919.80€, në emër të borxhit me kamatë ligjore 8% në vit duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartuesi privat do të zbatoj përmbartimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit me shitjen e tyre dhe të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, në të cilin ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar urdhrin për përmbartim me arsyetimin se ende nuk ka arritur afati për pagesë, pasi që kreditori nuk ka caktuar afatin brenda të cilit duhet të bëhet pagesa, andaj ka konsideruar se debitori ka ende afat për kryerjen e obligimeve. Gjykatës i ka propozuar që ta anuloj urdhrin.

Kreditori brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara dhe të paargumentuara. Më tej ka theksuar se pretendimi i debitorit se faturat nuk kanë afat pagese nuk qëndron, për faktin se secila faturë ka

afatin e caktuar bazuar në kontratën publike kornizë e cila ka kaluar procedurat e prokurimit. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe të lë në fuqi urdhrin përmbartimorë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkalles së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerr aktvendimin KPPP. nr.33/24 dt.24.05.2024 me të cilin ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit ka vlerësuar se Urdhri përmbartimor P.nr.656/21 i datës 22.06.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr.023256 e datës 15.08.2018 në shumën prej 5,932.00€, për shkak se kjo faturë nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së. Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.656/21 të datës 22.06.2021, sipas Faturës Nr.027777 të datës 03.09.2019 në shumën prej 45,993.60€ dhe sipas Faturës Nr. 031553 të datës 21.08.2020 në shumën prej 44,994.20€, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Nisur nga një gjendje faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkalles së dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë pasi gjendja faktike nuk është vërtetuar mirë dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e shkalles së dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Ne shqyrtim dhe analizim të gjendjes së provave, kjo gjykatë konstaton se kreditori propozimin për përmbartim e ka mbështetur në dokumente të besueshme përkatësisht Faturës Nr.023256 e datës 15.08.2018 në shumën prej 5,932.00€, Faturës Nr.027777 e datës 03.09.2019 në shumën prej 45,993.60€ si dhe Faturës Nr. 031553 e datës 21.08.2020 në shumën prej 44,994.20€, me të cilin ka detyruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 96,919.80€. Mirëpo në lidhje me detyrimet që dalin nga këto fatura, kjo gjykate gjenë se në lëndë ekzistojnë prova se debitori ka bërë shlyerjen e një pjese të detyrimit nga këto fatura në llogari të kreditorit, e kjo bazuar në disa urdhërpagesa të cilat debitori ia ka bashkangjitur shkresave të lendes si dëshmi se është paguar një pjesë e detyrimit që rrjedh nga këto fatura, e mbi bazën e të cilave është iniciuar procedura përmbartimore.

Pra, gjykata e shkalles së dytë konstaton se debitori për faturën nr. 023256 ka paguar katër këste dhe atë me datë 12.09.2018 shumën prej 10,000.00€, me datë 14.11.2018 shumën prej 10,000.00€, me datë 27.08.2019 shumën prej 6,000.00€ dhe me datë 26.05.2020 shumën prej 15,000.00€ ashtu që nga kjo faturë ka mbetur pa u paguar shuma prej 5,932.00€. Prandaj kjo gjykatë vlerëson se nuk është kontestuese se këtë pjesë të borxhit debitori e ka shlyer dhe nga fatura e lartcekur ka mbetur në borxh në shumën prej 5,932.00€. Fakti se fatura nuk ka qenë në original nuk e zhvesh debitorin nga detyrimi për ta paguar pjesën e mbetur pasi që të njëjtën

faturë pjesërisht e ka paguar me këste ashtu siç është dëshmuar nëpërmjet transaksioneve bankare.

Sa i përket faturave Nr.027777 e datës 03.09.2019 në shumën prej 45,993.60€ si dhe Faturës Nr. 031553 e datës 21.08.2020 në shumën prej 44,994.20€, të njëjtat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Prandaj, Gjykata e shkallës së dytë nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me gjendjen faktike të vërtetuar nga e njëjta. Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjënë se refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit si i bazuar dhe anulohet Urdhri P.nr.715/24 të datës 05.06.2024, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, dhe i njëjti Urdhër mbetet në fuqi në tërësi.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale të Kosovës për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1286/24, me datë 01.11.2024**

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**